



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada - Government
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Plani i Veprimit për Strategjinë për ndryshime klimatike

with funding from

Austrian
 **Development Cooperation**

**MBËSHTETUR NGA PROGRAMI I KOMBEVE TË BASHKUARA PËR
ZHVILLIM**

Gusht 2016

PËRMBAJTJA

PËRMBAJTJA.....	2
LISTA E SHKURTESAVE.....	4
1 HYRJE.....	5
1.1 Vizioni	6
1.2 Misioni	6
1.3 Fushat e ndikimit	6
1.4 Objektivat	6
1.5 Supozimet.....	7
1.6 Kufizimet.....	7
2 STRUKTURA MENAXHUESE	9
2.1 Struktura organizative	9
2.2 Rolet dhe përgjegjësitë.....	11
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH)	12
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR)	15
Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE)	16
Ministria e Integritit Evropian (MIE)	17
Ministria e Infrastrukturës (MI)	18
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI)	19
Ministria e Punëve të Brendshme (MIA)	20
3 METODOLOGJIA	21
3.1 Prioritarizimi i veprimeve	21
3.2 Klasifikimi i intervenimeve	23
3.2.1 Intervenimet strategjike	23
3.2.2. Intervenimet administrative.....	23
3.2.3 Investimet në infrastrukturë.....	24
3.2.4 Aktivitetet për ndërgjegjësimin e publikut.....	25
3.2.5 Intervenimet financiare dhe ekonomike	25
4 UDHËRRËFYESI PËR IMPLEMENTIM	25
4.1 Intervenimet e përbashkëta (KZHEU dhe KPK)	26
4.1.1 Intervenimet e përbashkëta strategjike	26
4.1.2 Intervenimet e përbashkëta administrative.....	27
4.1.3 Intervenimet për ndërgjegjësim publik	28
4.1.4. Intervenimet financiare dhe ekonomike	29
4.2 Zhvillimi me emetime të ulëta	29

4.2.1. Intervenimet strategjike të KZHEU-së	29
4.2.2. Intervenimet administrative të KZHEU-së	31
4.2.3. Intervenimet e KZHEU-së që lidhen me investimet në infrastrukturë	31
4.3 Komponenti i Përshtatjes Kombëtare	32
4.3.1. Intervenimet strategjike të KPK-së	32
4.3.2. Intervenimet administrative për KPK	33
4.3.3. Intervenimet për KPK që lidhen me investime në infrastrukturë.....	34
5 PLANI I VEPRIMIT	35
5.1 Masat e vazhdueshme (2016-2024).....	35
5.2 Intervenimet afatshkurta (2016-2018).....	40
5.3 Masat afatmesme (2019-2021).....	43
5.4 Masat afatgjata (2022-2024).....	46
6 PLANI I MONITORIMIT	48
6.1 Rolet dhe përgjegjësitë.....	49
6.2 Korniza logjike	51
6.3 Rrjedha e të dhënave	54
6.4 Menaxhimi i të dhënave.....	55
6.5 Indikatorët.....	55

LISTA E SHKURTESAVE

PV – Plani i Veprimit

SNK - Strategjia për Ndryshime Klimatike

DMM - Departamenti për Mbrojtje të Mjedisit

BE – Bashkimi Evropian

GS – Gazrat Serë

GIS – Sistemi për Informata Gjeografike

GPNM - Grupi Punues Ndër-Ministror për Ndryshime Klimatike

PKEE – Plani i Veprimit i Kosovës për Eficiencë të Energjisë

AMMK - Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës

SKM – Strategjia e Kosovës për Mjedisin

KZHEU – Komponenta për Zhvillim me Emetime të Ulëta

MBPZHR - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

ASHK – Analiza me shumë kritere

MZHE - Ministria e Zhvillimit Ekonomik

MIE - Ministria e Integritimit Evropian

MMPH - Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

MI - Ministria e Infrastrukturës

MPB - Ministria e Punëve të Brendshme

MTI - Ministria e Tregtisë dhe Industrisë

KPK – Komponenta e Përshtatjes Kombëtare

PKVM - Plani Kombëtar i Veprimit për Mjedis

TC – Termocentral

UNFCCC - Konventa Kornizë e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike

UNDP - Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara

1 HYRJE

Kosova ende nuk është pjesëmarrëse dhe nuk ka nënshkruar Konventën Kornizë të OKB-së për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC), Protokollin e Kiotos dhe Marrëveshjen e Parisit. Megjithatë, ajo ka përgjegjësi për t'iu përgjigjur kërkesave të Konventës dhe Protokollit, pasi është nënshkruese e Traktatit të Komunitetit për Energji.¹ Traktati i Komunitetit për Energji përcakton objektiva të qarta të reduktimit të shfrytëzimit të energjisë dhe kërkon rritjen e shfrytëzimit të energjisë së ripërtëritshme. Mu për këtë, hartimi i Strategjisë për Ndryshime Klimatike (SNK) është përcaktuar si një nga prioritetet në Strategjinë Mjedisore të Kosovës (SMK) dhe Planin Kombëtar të Veprimit për Mjedis (PKVM) për periudhën 2011-2015 dhe poashtu është identifikuar si prioritet për procesin e përafrimit të Kosovës me BE-në.

Zhvillimi i Strategjisë për Ndryshime Klimatike (SNK) ka filluar në dhjetor 2012 nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) dhe është përkrahur nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP). SNK-ja është përfunduar gjatë vitit 2014. Ajo ka dy komponente kryesore, komponenten për zhvillim me emetime të ulëta (KZHEU) dhe komponenten e përshtatjes kombëtare (KPK). Strategjia gjithashtu përmban 8 formularë të intervenime nën komponenten për zhvillim me emetim të ulët dhe 18 formularë të intervenimeve nën komponenten e përshtatjes kombëtare.

Strategjia përcakton një kornizë gjithëpërfshirëse të politikave për zbutje të ndryshimeve klimatike, duke përfshirë edhe udhëzimin për ndërmarrjen e hapave të duhur nga Kosova për të përmbushur kërkesat e BE-së si dhe përgjegjësitë globale në të ardhëmen.

Kosova ka zhvilluar Strategjinë për Zhvillim Kombëtar 2016-2021 (SZHK), e cila në aspektin strukturor është e ndarë në katër shtylla tematike: kapitali njerëzor, sundimi i ligjit dhe qeverisja e mirë, zhvillimi i industrive konkurruese dhe zhvillimi i infrastrukturës. Shtyllat e Industrive konkurruese dhe Infrastrukturës përshkruajnë drejtimet e zhvillimit të **sektorit industrial** (shfrytëzimi i potencialit të mineraleve, përpjekjet për rivitalizimin e Trepçës), **sektorit të energjisë** (zhvillimi i kapaciteteve të reja të qëndrueshme gjeneruese të energjisë, themelimi i tregut të hapur të energjisë, implementimi i masave të efijencës së energjisë dhe përdorimi racional i energjisë së ripërtëritshme), **infrastrukturës hekurudhore dhe rrugore, zhvillimit të agrobiznesit**, përdorimit racional të **burimeve ujore** dhe menaxhimi i qëndrueshëm i **pyjeve dhe mbeturinave**. Mbrojtja e Mjedisit dhe Ndryshimet Klimatike nuk janë inkorporuar mjaftë mirë në SZHK pasi nuk shtjellohet mënyra konkrete e trajtimit të tyre. Industritë Konkurruese dhe Infrastruktura paraqesin dy shtyllat më të rëndësishme për zhvillimin e vendit dhe në të njëjtin kohë paraqesin kërcënimet më sfiduese për mjedisin dhe ndryshimin klimatik.

Kosova gjithashtu ka zhvilluar Strategjinë Shtetërore të Ujërave 2015-2034, i cili është dokumenti kryesor për planifikimin dhe menaxhimin e resurseve ujore. Dokumenti është i ndarë në katër qasje sektoriale të cilat janë: shfrytëzimi i ujit, mbrojtja e ujit, mbrojtja nga uji dhe qeverisja e ujit. Dokumenti do të shfrytëzohet nga MMPH-ja si udhëzues për zhvillim të politikave, zhvillim operativ dhe investime në sektorin e ujërave për periudhën kohore 20 vjeçare.

Autoriteti përgjegjës për politikën për mjedis dhe klimë është Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Në vitin 2012, me mbështetje nga UNDP-ja, Kosova ka përpiluar inventarizimin e parë të

¹ Për UNDP-në, referencat për Kosovën duhen kuptuar se janë në kontekst të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit (1999).

saj për gazrave serrë (GS) për periudhën 2008-2009. Ministria e Zhvillimit Ekonomik është përgjegjëse për politikat për energji dhe është duke bërë përpjekje për të arritur objektivat e BE-së 20-20-20 në kuadër të Traktatit të Komunitetit për Energji. Ajo ka hartuar Planin e Veprimit për Energji të Ripërtëritshme dhe Planin e Veprimit për Efiçencë të Energjisë, ka themeluar Agjencinë e Kosovës për Efiçencë të Energjisë, dhe ka planifikuar disa projekte për zvogëlimin e Gazrave Serë (GS) në ndërtesa dhe në sektorë tjerë.

Zhvillimi i strategjisë për ndryshime klimatike është bërë me pjesëmarrje gjithëpërfshirëse dhe është siguruar konsultimi ndërmjet institucioneve qendrore dhe lokale. Për këtë qëllim është themeluar Grupi Punues Ndër-Ministror për Ndryshime Klimatike (GPNM) në mars 2013 nga Ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Për të siguruar monitorimin e zbatimit dhe raportimin lidhur me nivelin e zbatimit dhe arritjes së objektivave të përcaktuara në Strategji, është i nevojshëm zhvillimi i Planit të detajuar të Veprimit për zbatimin e SNK-së.

1.1 Vizioni

SNK-ja përcakton një vizion të një Kosove reziliente ndaj klimës, e cila në mënyrë efektive zbutë shkaqet e ndryshimeve klimatike, i parashikon dhe i përgjigjet ndikimeve të ndryshimeve klimatike, duke marrë parasysh parimet ndërkombëtare për zhvillim të qëndrueshëm.

1.2 Misioni

Vizioni i përcaktuar i SNK-së synon zvogëlimin e rreziqeve dhe dëmeve nga ndikimet aktuale dhe të ardhshme të ndryshimeve klimatike me një kosto efektive dhe duke shfrytëzuar përfitimet të cilat mund të i sjellin ndryshimet klimatike.

Misioni i këtij dokumenti është që të lehtësojë procesin e zbatimit të SNK-së, duke njohur hapat e nevojshëm për veprim, parakushtet, pengesat dhe prioritetet ekzistuese.

1.3 Fushat e ndikimit

Plani i Veprimit për zbatimin e SNK-së përfshin komponenten për zhvillim me emetime të ulëta dhe komponenten e përshtatjes kombëtare. Plani paraqet rrjedhën e detajuar të veprimeve dhe hapave, duke përmbledhur prioritetet dhe duke mundësuar planifikim më të mirë strategjik në sektorë të ndryshëm, posaçërisht kur bëhet fjalë për planifikimin financiar (buxhetor) dhe të investimeve në periudhën e ardhshme.

1.4 Objektivat

Objektivi i përgjithshëm i PV-së:

Të mundësojë arritjen e qëllimeve të SNK-së hap-pas-hapi, duke mundësuar planifikim më të mirë strategjik dhe financiar, monitorim dhe raportim për zbatimin, përcaktimin e prioritetëve dhe

njohjen e domosdoshmërive në dy komponentat e saj dhe dokumenteve të tjera relevante strategjike.

Objektivi specifik i PV-së 1:

Të sigurojë integrimin e politikës nacionale për ndryshime klimatike në politikat relevante sektoriale, duke shmangur dyfishimin e përpjekjeve dhe duke tejkaluar mospërputhjet ndërmjet SNK-së dhe dokumenteve të tjera relevante strategjike.

Objektivi specifik i PV-së 2:

Të sigurojë kornizë adekuate ligjore dhe rregullim institucional për zbatimin e SNK-së përmes fuqizimit të institucioneve, trajnimit të profesionistëve dhe sjelljen e mekanizmave të përshtatshëm për përmirësimin e komunikimit, bashkëpunimit dhe menaxhimit të informatave.

Objektivi specifik i PV-së 3:

Të sigurojë investimin në infrastrukturën relevante dhe zhvillimin e masave të përshtatshme financiare/fiskale si instrumente për arritjen e qëllimeve të SNK-së.

Objektivi specifik i PV-së 4:

Të sigurojë rritje të ndërgjegjësimit publik për ndryshimet klimatike, për efektet e tyre negative dhe rreziqet, mundësitë për përshtatje dhe zvogëlim të rrezikut apo edhe shfrytëzim të përfitimeve të mundshme.

1.5 Supozimet

Përkushtimi i vendim-marrësve

Suksesi i këtij dokumenti varet nga përkushtimi i fuqishëm i autoriteteve kompetente, posaçërisht në lidhje me sigurimin e fondeve dhe respektimin e afateve të përcaktuara në Plan të Veprimit.

Funksionimi i mekanizmave koordinues ndër-sektorial të themeluar

Grupi Punues Ndër-Ministror për Ndryshime Klimatike (GPNM) është themeluar në mars 2013 nga Ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor si mekanizëm për të lehtësuar harmonizimin ndër-sektorial si dhe lidhjet vertikale ndërmjet nivelit qendror dhe atij lokal. Funksionimi i grupeve të tilla joformale nuk është gjithmonë i lehtë, meqë shumë shpesh ka mungesë të formulimit të saktë të rregullave dhe të përgjegjësve e të cilat janë të domosdoshme për funksionimin si duhet.

1.6 Kufizimet

Për zbatimin e Planit të Veprimit, i cili është mjaftë ambicioz, paraqet kufizim sigurimi i fondeve, si nga resurset vendore ashtu edhe nga ato ndërkombëtare..

Ndërsa, për masat dhe intervenimet të cilat nuk kërkojnë investime të konsiderueshme financiare (p.sh. masat administrative) duhet patjetër të arrihet përkushtimit serioz nga vendim-marrësit në mënyrë që të lehtësohet ngritja e kapaciteteve, procesi i hartimit të ligjeve dhe implementimi me kohë i masave të tilla.

Kapaciteti administrativ mund të konsiderohet si kufizim serioz, meqë administratat e vogla shpesh vuajnë nga mungesa e ekspertizës specifike, kapacitetit të kufizuar për absorbim (shumë trajnime të ndryshme për të njëjtin grup të njerëzve), mbingarkesa me shumë detyra paralele, etj.

Përveç këtyre, pengesat e tjera të cilat duhet marrë parasysh janë:

- Kosova ende nuk është palë nënshkruese e (UNFCCC)
- Informatat për emetimet e GS-ve e posaçërisht projektimet e GS-ve, janë ende të pamjaftueshme.


Në këtë Plan të Veprimit, mungesa e informatave lidhur me emetimet dhe projektimet e GS-ve është arsyeja kryesore për shpërndarjen e pabarabartë të masave për zvogëlimin dhe atyre të përshtatjes.

Mu për këtë komponentja e përshtatjes është më e mirë dhe e shtjelluar më shumë, ndërsa komponentja e zbutjes mbështetet më shumë në ngritjen e kapaciteteve dhe planifikimin strategjik.


2 STRUKTURA MENAXHUESE

2.1 Struktura organizative

Në Kosovë, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) ka rolin udhëheqës për koordinimin e aktiviteteve kombëtare për ndryshimet klimatike dhe aktiviteteve të Qeverisë për t'u përballur me ndikimet e pritura të ndryshimeve klimatike. Struktura organizative e MMPH-së është paraqitur në vijim:



Në kuadër MMPH-së, Departamenti për Mbrojtje të Mjedisit udhëheq aktivitetet kombëtare për hartimin e dokumenteve strategjike për ndryshimet klimatike. Struktura e departamentit është paraqitur në diagramin e mëposhtëm:



Roli drejtues i MMPH-së dhe Departamentit për Mbrojtje të Mjedisit konfirmohet me Vendimin e Qeverisë së Kosovës Nr. 05/45 (datë 21.08.2015) për themelimin e Këshillit Kombëtar për Ndryshime Klimatike.

2.2 Rolet dhe përgjegjësitë

Këshilli Kombëtar për Ndryshime Klimatike

Këshilli Kombëtar për Ndryshime Klimatike është përgjegjës që të përcjellur zbatimin e dokumenteve strategjike dhe planit të veprimit për ndryshime klimatike, në përputhje me kërkesat e UNFCCC-së dhe Protokollit të Kiotos.

Funksionet kryesore të Këshillit Kombëtar për Ndryshime Klimatike janë si në vijim:

- Koordinon të gjitha aktivitetet që dalin nga UNFCCC-ja dhe Protokollit të Kiotos,
- Siguron që projektet me ndikim në ndryshimet klimatike të realizohen në përputhje me legjislacionin vendor dhe marrëveshjet ndërkombëtare,
- Përgatit dokumentacionin e nevojshëm për pjesëmarrjen dhe anëtarësimin në konventa ndërkombëtare, protokolle dhe marrëveshje që kanë të bëjnë me ndryshimet klimatike, dhe
- Bënë përgatitjen e Komunikimit Kombëtar për Sekretariatit e Konventës UNFCCC pas ratifikimit të Protokollit të Kiotos.

Këshilli Kombëtar për Ndryshime Klimatike ka përbërjen si në vijim:

- Ministri i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) – Kryesues i Këshillit
- Ministri i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik (MED) – anëtar
- Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) - anëtar
- Ministri i Ministrisë së Infrastrukturës (MI) – anëtar
- Ministri i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë (MTI) – anëtar
- Ministri i Ministrisë për Integritet Evropian (MIE) – anëtar
- Ministri i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) - anëtar

Si pjesë e Këshillit Kombëtar për Ndryshime Klimatike, është themeluar gjithashtu edhe Sekretariati Teknik i Këshillit, i cili përgatit dhe lehtëson punën e Këshillit. Sekretariati Teknik përbëhet nga anëtarët në vijim:

- Drejtori i Departamentit për Mbrojtje të Mjedisit – Kryesuesi
- Drejtori i Departamentit për Ujëra – Anëtar
- Drejtori i Departamentit për Energji – Anëtar
- Drejtori i Departamentit për Infrastrukturë Rrugore – Anëtar
- Drejtori i Departamentit për Industri – Anëtar
- Drejtori i Departamentit për Pylltari – Anëtar
- Drejtori i Departamentit për Politika Bujqësore dhe Treg – Anëtar
- Drejtori i Departamentit për Politika Sektoriale – Anëtar
- Drejtori i Institutit Hidrometeorologjik – Anëtar
- Përfaqësuesi nga shoqëria civile – Anëtar
- Përfaqësuesi nga Universiteti – Anëtar
- Përfaqësuesi nga UNDP-ja – Anëtar


Grupi Punues Ndër-Ministror (GPNM)

Grupi Punues Ndër-Ministror (GPNM) përmirëson koordinimin Qeveritar për politikën për ndryshime klimatike, për të siguruar se Qeveria njihet cenueshmërinë e vendit, efektet negative nga ndryshimet klimatike, dhe njëherit ajo i zhvillon masat dhe veprimet e duhura, afatshkurta dhe afatmesme, për

zbutje dhe përshtatje ndaj ndryshime klimatike. , ashtu që vendi të jetë në gjendje të përballet me ndikimet e ndryshimeve klimatike.

GPNM-ja ka tri nëngrupe:

- Nëngrupi për Inventarizimin e Gazrave Serë – i udhëhequr nga Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK)
- Nëngrupi për reduktim të Gazrave Serë – i udhëhequr nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE)
- Nëngrupi për përshtatje – i udhëhequr nga MMPH-ja - Departamenti për Mbrojtje të Mjedisit (DMM)



Gjatë procesit të zhvillimit të SNK-së, ministritë dhe institucionet në vijim janë përfshirë si anëtarë të Grupit Punues Ndër-Ministror (përmes departamenteve dhe/ose divizioneve të tyre).

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH)

Mandati i MMPH-së është rregulluar me Rregulloren 02/2011 për Fushat e përgjegjësisë së Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive. Sipas kësaj rregulloreje, MMPH-ja është përcaktuar si institucioni kryesor përgjegjës në Kosovë për hartimin (e legjislacionit primar, sekondar dhe dokumenteve tjera strategjike), monitorimin dhe implementimin e legjislacionit në fushën e Mbrojtjes së Mjedisit, Ujërave, Banimit edhe Ndërtimit dhe Planifikimit Hapësinor. Gjithashtu, MMPH-së është caktuar përgjegjëse për të udhëhequr koordinimin e aktiviteteve me ministritë linjë dhe autoritetet ndërkombëtare në sektorin e mbrojtjes së mjedisit; për të vlerësuar gjendjen e mjedisit në Kosovë, për të nxjerrë udhëzime, për të përcaktuar norma dhe standarde në pajtim me standardet e pranuar ndërkombëtare.

Sa i përketë ndryshimet klimatike, MMPH-ja përmes departamentit të saj për Mbrojtje të Mjedisit, udhëheq Grupin Punues Ndër-Ministror (GPNM), koordinon aktivitetet me ministritë tjera të linjës, agjencitë dhe organizatat ndërkombëtare si psh UNDP-në dhe ndihmon në procesin e hartimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Ndryshime Klimatike dhe Planin e Monitorimit.

Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit

Detyra kryesore e Departamentin për Mbrojtje të Mjedisit është të koordinojë aktivitetet në fushën e mbrojtjes së mjedisit në mënyrë që të promovojë politika koherente, norma dhe standarde, të hartojë udhëzime, të merr pjesë në përgatitjen dhe realizimin e aktiviteteve për ndërgjegjësim

publik për mbrojtjen e mjedisit, ndryshimet klimatike si dhe kryen aktivitete të ndryshme për anëtarësim në organizata ndërkombëtare. Departamenti ka katër divizione (siç janë paraqitur në strukturën organizative më lartë): Divizioni për edukim dhe ndërgjegjësim mjedisor, Divizioni për mbrojtje nga ndotja industriale, Divizioni për mbeturina dhe kimikate dhe Divizioni për mbrojtje të natyrës.

Divizioni për edukim dhe ndërgjegjësim mjedisor

Detyrat kryesore të Divizionit për edukim dhe ndërgjegjësim mjedisor janë të planifikojë dhe të organizojë fushata të ndërgjegjësimit për mbrojtje të mjedisit, përpilim të fletushkave dhe sensibilizim të publikut të përgjithshëm, duke përçuar porosi dhe promovuar mbrojtjen e mjedisit si dhe përdorimin e qëndrueshëm të resurseve natyrore.

Divizioni për mbrojtje nga ndotja industriale

Ky divizion kryen aktivitete profesionale dhe harton legjislacionin primar dhe sekondar, duke përfshirë metodologjitë dhe dokumentet strategjike që lidhen me Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor (VNM), Vlerësimin Strategjik Mjedisor (VSM), mbrojtjen e cilësisë së ajrit, marrjen me çështjet e ndryshimeve klimatike, mbrojtjen nga ndotja industriale, mbrojtjen e shtresës së ozonit, mbrojtjen nga zhurma, planifikimin dhe parandalimin në raste të aksidenteve mjedisore.

Divizioni për mbrojtjen e natyrës

Detyra kryesore e Divizionit për mbrojtjen e natyrës është që të hartojë legjislacionin primar dhe sekondar për mbrojtjen e natyrës siç parashihet në Ligjin për mbrojtjen e natyrës.

Divizioni për mbeturina dhe kimikate

Përgjegjësia kryesore e Divizionit për mbeturina dhe kimikate është të hartojë legjislacionin për menaxhimin e mbeturinave, kimikateve dhe produkteve biocide. Ai gjithashtu bënë licencimin e operatorëve ekonomik për menaxhim të mbeturinave; lëshon lejet dhe autorizimet për regjistrim të mbeturinave, kimikateve dhe produkteve biocide.

Departamenti për ujëra

Detyrat kryesore të departamentit për ujëra janë që të hartojë legjislacionin primar, sekondar dhe dokumentet strategjike për përdorimin e qëndrueshëm të resurseve ujore, planet e menaxhimit për pellgjet lumore, dhe normat rregullative për mbrojtjen e rrjedhave të ujit. Ai lëshon leje për ujë për të gjithë përdoruesit e resurseve ujore dhe propozon investime kapitale. Ky departament ka tri divizione: Divizioni për politika të përgjithshme, Divizioni për menaxhimin e resurseve ujore dhe Divizioni për koordinimin e pellgjeve lumore.

Inspektorati i mjedisit, ujit, planifikimit hapësinor dhe ndërtimit

Përgjegjësitë kryesore të Inspektoratit të mjedisit, ujit, planifikimit hapësinor dhe ndërtimit është që të kryejë inspektime të vazhdueshme, mbikëqyrje dhe kontroll të implementimit të ligjeve dhe udhëzimeve administrative që lidhen me mbrojtjen e mjedisit dhe parandalimin e ndotjes, menaxhimin e resurseve ujore, mbrojtjen e cilësisë së ajrit, mbrojtjen e natyrës, menaxhimin e

mbeturinave dhe kimikateve, përdorimin e qëndrueshëm të resurseve natyrore, planifikimin urban dhe rural, ndërtimin dhe përshtatshmërinë me kodet ndërtimore. Inspektorati i mjedisit, ujit, planifikimit hapësinor dhe ndërtimit koordinon aktivitetet e tij me departamentin përkatës komunal të inspektoratit lidhur me çështjet e interesit të përbashkët.

Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës

AMMK-ja është institucion qeveritar i cili angazhohet për të mbrojtë dhe mirëmbajë cilësinë e ajrit, ujit, dheut dhe biodiversitetit përmes monitorimit të integruar mjedisor, sistemit efikas të informimit mjedisor dhe raportimit të vazhdueshëm për gjendjen mjedisore. Poashtu, angazhohet për promovimin e përdorimit të burimeve të ripërtëritshme të energjisë dhe shfrytëzimit të qëndrueshëm të resurseve natyrore në mënyrë që të sigurojë mjedis të shëndetshëm për gjeneratat aktuale dhe ato të ardhshme, në harmoni me progresin e qëndrueshëm ekonomik dhe social. Struktura organizative e këtij Agjencioni është si në vijim:

Sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2016 për Mekanizmin e Monitorimit të Gazrave Serë (GS) – AMMK-ja është përgjegjëse për hartimin e Inventarit Kombëtar të GS-ve, raportimin lidhur me projektimet për GS raportimin për veprimet kombëtare për përshtatje dhe për të bërë sigurimin dhe kontrollimin e cilësisë.

Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës


Ligji për aktivitetet hidrometeorologjike (Nr. 02/L-79, 2006) përcakton fushëveprimi e punës dhe përgjegjësitë e Institutit Hidrometeorologjik të Kosovës. Poashtu përcakton mënyrën e kryerjes së detyrave dhe aktiviteve, harmonizimin e politikave dhe standardeve me Organizatën Meteorologjike Botërore (WMO). Instituti Hidrometeorologjik kryen të gjitha llojet e testimeve, matjeve dhe observimeve të dukurive meteorologjike, hidrologjike, bio-meteorologjike, hidro-biologjike; shtjellimin dhe publikimin e rezultateve të nxjerra të matjeve dhe observimeve; publikimin e informatave të rregullta dhe periodike për motin, gjendjen e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, cilësinë e ajrit, kryen kërkime për të vlerësuar ndikimin e ndryshimeve klimatike dhe të temperaturës në ciklin hidrologjik, etj.

Për qëllime të zhvillimit të Planit të Veprimit dhe Monitorimit për Ndryshime Klimatike, Instituti Hidrometeorologjik do të ofrojë informata për ndryshimet e temperaturave përgjatë kohës, të dhënat për cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, nivelet e rrjedhës së lumenjve kryesor në Kosovë, gamën e reshjeve dhe cilësinë e ajrit.

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR)

Roli dhe përgjegjësia e MBPZHR-së është përcaktuar me Rregulloren 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë së Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive. MBPZHR-ja është përcaktuar si institucioni kryesor përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e legjislacionit primar dhe sekondar për zhvillimin e bujqësisë, menaxhimin e shfrytëzimit të tokës, zhvillimin rural, menaxhimin e sektorit të pylltarisë, duke përfshirë mbrojtjen dhe ripyllëzimin, mbrojtjen nga zjarri dhe parandalimin e tyre, dezinfektimin kundër insekteve dhe sëmundjeve të ndryshme të bimëve. Në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë, atë të Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, ajo kryen kontrollin e cilësisë së ushqimit dhe aktivitete të ndërlidhura për mbrojtje të mjedisit.

Struktura organizative e MBPZHR-së është paraqitur në diagramin më poshtë:




Për qëllime të zhvillimit të Planit të Veprimit dhe Monitorimit për Ndryshime Klimatike, MBPZHR-ja e mbështetë MMPH-në dhe GPNM-në duke ofruar informata lidhur me shfrytëzimin e tokës dhe prodhimin bujqësor, pylltarinë, strukturën blegtorale dhe shpezërinë, etj.

Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE)

Në pajtim me Shtojcën 18 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE) ushtron kompetencat në vijim: harton politika dhe strategji për zhvillim ekonomik, mbështet zhvillimin e ekonomisë së tregut, liberalizimin e tregut në shërbimet publike, kryeson Këshillin Ministror për Ndërmarrjet në Pronësi Publike dhe mbështetë debatet Qeveritare për çështjet që kanë të bëjnë me Ndërmarrjet në Pronësi Publike, përpilon raportin vjetor për performancën e Ndërmarrjeve në Pronësi Publike, përgatit dhe monitoron zbatimin e legjislacionit në sektorët e energjisë dhe minierave, shërbimet postare, telekomunikimet, teknologjinë informative dhe mbikëqyr Ndërmarrjet në Pronësi Publike, harton dhe zbaton dokumente strategjike për sektorët e energjisë dhe minierave për bilancin energjetik, harton politika për Eficiencën e Energjisë dhe Burimet e Energjisë së Ripërtërishme, si dhe planet relevante të veprimit për sektorët e sipërpërmendur.

Struktura organizative e MZHE-së është paraqitur në diagramin e mëposhtëm:




Për qëllime të zhvillimit të Planit të Veprimit dhe Monitorimit për Ndryshime Klimatike, MZHE-ja, përmes Departamenteve të veta të Energjisë dhe Minierave dhe agjencive përkatëse, do t'i ofrojë GPNM-së të dhënat që kanë të bëjnë me Energjinë dhe Minierat.

Ministria e Integritit Evropian (MIE)


Ministria e Integritit Evropian ka për misionin kryesor drejtimin, koordinimin dhe monitorimin e të gjitha aktiviteteve drejt integritit të Republikës së Kosovës në Bashkimin Evropian duke hartuar dokumente strategjike për avancimin e zbatimit të kritereve dhe detyrimeve që kërkohen me procesin e integritit Evropian, duke ndihmuar dhe organizuar mekanizmat e koordinimit të donatorëve, duke mbështetur ministrinë e linjës në përafrimin e legjislacionit në pajtueshmëri me Direktivat Evropiane specifike.

Struktura organizative e MIE-së është paraqitur në diagramin e mëposhtëm:




Ministria e Infrastrukturës (MI)

Detyrat dhe përgjegjësitë e Ministrisë së Infrastrukturës janë përcaktuar me Nenin 17 të Rregullores Qeveritare Nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive. Përgjegjësitë kryesore të MI-së janë si në vijim: të hartojë dhe të monitorojë implementimin dhe zbatimin e politikave, dokumenteve strategjike në sektorin e infrastrukturës, transportit rrugor, transportit hekurudhor, aviacionit civil, telekomunikacionit dhe teknologjisë informative.




Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI)

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë harton, mbikëqyrë dhe shtynë zbatimin e legjislacionit primar dhe sekondar dhe dokumenteve strategjike për tregti, industri, punë komerciale, produkte industriale dhe të ndërtimtarisë. Ajo përkrahë investimet në Kosovë, ofron informata për investitorët potencial, bën përshtatjen e investitorëve me partnerët vendorë, ndihmon investitorët në marrjen e lejeve dhe autorizimeve të nevojshme dhe grumbullon e publikon të dhënat për investimet e huaja.



Ministria e Punëve të Brendshme (MIA)

Edhe pse MPB-ja nuk është as anëtare e Këshillit Kombëtar për Ndryshime Klimatike e as anëtare e Sekretariatit, ne besojmë që MPB-ja mund të përfshihet përmes Agjencisë së saj për Reagim Emergjent, në veçanti në fushën e sigurisë publike, gatishmërisë dhe reagimit emergjent.



3 METODOLOGJIA

3.1 Prioritarizimi i veprimeve

Procesi i identifikimit të prioriteteve ndër masat e parapara me Strategjinë për Ndryshime Klimatike 2014-2024 ka përfshirë një analizë të faktorëve të ndryshëm që ndërlidhen me gjendjen faktike në Kosovë, duke marrë në konsideratë politikat zhvillimore, disponueshmërinë e fondeve si dhe rreziqet e mundësitë specifike që lidhen me dukurinë e ndryshimeve klimatike.

Strategjia për Ndryshime Klimatike për Kosovën propozon dy grupe masash:

- Masat e rekomanduara për Zhvillim me Emetime të Ulëta
- Masat e Rekomanduara të Përshtatjes

Këto dy grupe të masave janë shtjelluar në Strategjinë për Ndryshime Klimatike me nivele të ndryshme të hollësive dhe me një analizë paraprake. Të dyja grupet përmbajnë 9 rekomandime të përgjithshme të paraqitura në tabelat 1 dhe 2 më poshtë, sipas sektoreve, dhe të renditura sipas prioriteteve të tyre.

Megjithatë, secila nga këto masa të përgjithshme duhet të ndahen në sekuencë hapash, duke marrë parasysh që shumë hapa të masave të ndryshme mund të realizohen në të njëjtën kohë.

Masat e rekomanduara për përshtatje janë shtjelluar më tej duke u bazuar në analizën me kritere të shumëfishta (AKSH²), ashtu që të ofrohet një renditje e përgjithshme e 38 intervenimeve të pranuar dhe që të dallohen intervenimet afatshkurta, afatmesme dhe ato afatgjata. Ndërkaq për masat për reduktimin e emetimeve të GS-ve janë pranuar disa hapa, por shtjellimi i mëtejshëm është ndërprerë për shkak të nivelit të pamjaftueshëm të informatave për emetimet aktuale dhe ndikimin e veprimeve individuale në zvogëlim të emetimeve.

Tabela 1. Masat për reduktimin e emetimit të GS-ve

	Masat e përgjithshme sektoriale
1	Ngritja e kapaciteteve
2	Efiçienca e energjisë
3	Energjia e ripërtëritshme
4	Ngrohja qendrore dhe kogjenerimi industrial
5	Termocentralet dhe minierat e thëngjillit
6	Transporti
7	Menaxhimi i mbeturinave
8	Bujqësia
9	Pyjet dhe natyra

² 8 kriteret në vijim janë përdorur për analizën: (1) Çështjet teknike (p.sh. lehtësia e implementimit, bollshmëria dhe fuqia e zgjidhjes, fleksibiliteti ndaj kushteve në ndryshim, qëndrueshmëria); (2) Kostot e vlerësuara (3) Ndikimet në cilësinë dhe sasinë e ujit; (4) Çrregullimi i vendbanimit (ujor, bregor, kodrinor); (5) Ndikimet ekologjike dhe mjedisore; (6) ndikimet socio-ekonomike (komoditetet e komunitetit, mundësitë për turizëm, çrregullimi i fshatit, çështjet fetare, historike/arkeologjike); (7) Çështjet institucionale (përshtatshëmria); (8) Çështjet politike

Tabela 2. Masat e përshtatjes

	Masat e përgjithshme sektoriale
1	Mbrojtja nga përmbytjet
2	Thatësira/rrjedha e ulët/pamjaftueshmëria e ujit
3	Menaxhimi i pyjeve dhe biodiversitetit
4	Shëndeti publik
5	Menaxhimi dhe shkëmbimi i informatave
6	Ngritja e kapaciteteve, trajnimi, ngritja e vetëdijes
7	Financat, kthimi i kostos dhe menaxhimi i riskut
8	Strukturat bashkëpunuese
9	Të ndryshme

Në shikim të parë duket se ka disa mbivendosje nëpër sektorë nga dy grupet e masave, edhe pse zbutja dhe përshtatja mund të kenë qasje të ndryshme. Megjithatë, disa masa siç janë ngritja e kapaciteteve dhe menaxhimi i pyjeve mund të trajtohen si masa të përbashkëta, mirëpo me hapa të ndryshëm. E njëjta gjë vlen edhe për masat e dizajnuara për përmirësimin e menaxhimit dhe shkëmbimit të informatave si dhe për strukturat e bashkëpunimit.

Edhe pse është dhënë një prioritarizim i masave nga Strategjia për Ndryshime Klimatike, për të bërë një plan të mirëfilltë veprimi për periudhë afatgjatë (2016-2024), ka qenë e domosdoshme përcaktimi i periudhës së implementimit të masave afatshkurta, afatmesme dhe afatgjatë. Në këtë mënyrë, masat urgjente duhet të implementohen sa më shpejtë që është e mundur, duke filluar nga momenti i miratimit të Planit të Veprimit deri në fund të vitit 2018. Masat afatmesme duhet të implementohen në periudhën 2019-2021, ndërsa masat afatgjatë në periudhën 2021-2024. Përveç kësaj, ka qenë e nevojshme të përcaktohet numri i masave të cilat duhet të implementohen në vazhdimësi gjatë gjithë periudhës së mbuluar nga Plani i Veprimit.

Përcaktimi i periudhës së saktë për implementim të secilës masë dhe secilit hap bazohet në disa faktorë kufizues dhe faktorë favorizues:

Faktorët kufizues të marrë në konsideratë ishin:

- **Afati kohor** – (pa)mundësia për të implementuar masën në afatin e caktuar kohor;
- **Padisponueshmëria e fondeve** – disa masa kërkojnë investim të shumave financiare të konsiderueshme gjatë një periudhe kohore;
- **Mungesa e ekspertizës** – implementimi i masave të caktuara kërkon nivel të lartë të ekspertizës;
- **Mungesa e kornizës ligjore apo institucionale** – implementimi i masave të caktuara kërkon themelimin e kornizës së mirëfilltë ligjore apo institucionale para implementimit të tyre;
- **Mungesa e kompetencave të definuara në mënyrë të saktë** – kompetencat e padefinuara apo të definuara në mënyrë të paqartë janë pengesat serioze më të shpeshta në implementimin e masave të planifikuara;
- **Niveli i efikasitetit** – përderisa disa masa janë dëshmuar se kanë efikasitet të kufizuar në praktikat ndërkombëtare, për disa masa tjera vlerësimi i efikasitetit mund të jetë i vështirë për shkak të dhënave të pamjaftueshme.

Faktorët në vijim janë konsideruar si të **favorshëm**:

- **Afati kohor** – korrespondon me kornizën kohore të rekomanduar në Strategjinë për Ndryshime Klimatike
- **Masat Horizontale** – masat me efekt të shumëfishtë dhe të përgjithshëm të cilat në mënyrë sistematike do të kontribuonin në luftimin e ndryshimeve klimatike janë favorizuar;
- **Masat kombëtare** – masat, implementimi i të cilave është në nivel kombëtar, janë favorizuar krahas masave lokale/rajonale të cilat synojnë trajtimin e një problemi të vetëm lokal;
- **Serioziteti i problemit** – është faktor kyç në përcaktimin e prioriteteve (për shembull, nëse përmbytjet tashmë janë pranuar si kërcënim serioz, masat për t'i parandaluar ato do të mbizotërojnë krahas masave që lidhen me kërcënimet që mund të ndodhin në të ardhmen për shkak të ndryshimit klimatik);
- **Efiçienca e dëshmuar e masës**- për disa masa është dëshmuar efiçienca e tyre në praktikën ndërkombëtare, prandaj mbizotërojnë krahas masave të cilat nuk janë testuar mjaftueshëm apo që kanë shfaqur rezultate mesatare;
- **Disponueshmëria e fondeve** – nëse fondet për implementimin e masës së caktuar janë siguruar në tërësi apo pjesërisht, kjo gjë jep prioritet absolut për planifikimin racional strategjik;
- **Korniza ekzistuese ligjore/institucionale** – për një numër të madh masash kjo paraqet një parakusht të pashmangshëm.

3.2 Klasifikimi i intervenimeve

Analiza e intervenimeve të propozuara nga Strategjia për Ndryshime Klimatike ka rezultuar në dallimin e disa llojeve të intervenimeve të cilat mund të trajtohen në mënyrë të ngjashme për qëllime të planifikimit, monitorimit dhe raportimit. Ato janë:

3.2.1 Intervenimet strategjike

Intervenimet të cilat përfshijnë monitorimin dhe implementimin e dokumenteve strategjike kërkojnë zbatim të vazhdueshëm gjatë gjithë periudhës kohore të mbuluar nga ky Plan i Veprimit. Kjo qasje siguron integrimin e politikave klimatike në politikat tjera sektoriale në periudhën afatgjate, duke marrë në konsideratë se disa dokumente strategjike ekzistuese kanë afat të kufizuar kohor, disa intervenime strategjike janë parashikuar për periudhë afatshkurtër në mënyrë që të iniciohet procesi i integritit të politikave klimatike në politikat tjera sektoriale dhe të sigurohet raportimi për sektorët kyç që prekin apo preken nga ndryshimet klimatike. Për më tepër, është e nevojshme të vihet në pah që shumica e intervenimeve të propozuara nga SNK-ja gërshetohen me strategjitë ekzistuese, duke krijuar kështu dyfishim të përpjekjeve. Është shumë e rëndësishme të insistohet për integrimin e intervenimeve adekuate sektoriale në politikat dhe strategjitë relevante sektoriale dhe të fokusohet në monitorimin e implementimit të tyre në kuadër të kornizës së tyre sektoriale, e jo të humbet kohë dhe përpjekje në dyfishimin e obligimeve të ngjashme.

Këto intervenime janë paraqitur si intervenime “strategjike”, meqë ato i përkasin kornizës strategjike kombëtare.

3.2.2. Intervenimet administrative

Ky grup i intervenimeve është i lidhur me funksionimin e administratës publike dhe ka rëndësi parësore, pasi paraqet parakusht kryesor për implementimin e strategjisë. Intervenimet në këtë

grup përfshijnë aktivitetet për ngritjen e kapaciteteve, fuqizimin dhe themelimin e institucioneve dhe organeve, trajnimin e profesionistëve, krijimin e kornizës ligjore dhe procedurave administrative. Edhe pse disa hapa të përgjithshëm janë identifikuar në SNK-në, ky grup i intervenimeve kërkon planifikim të saktë strategjik dhe me përgjegjësi të qarta. Është inkurajuese se fondet e nevojshme për të implementuar këto intervenimeve janë mesatarisht të ulëta. Ekzistojnë disa lloje të intervenimeve administrative:

- **Intervenimet juridike** – kërkojnë hartimin dhe miratimin e akteve të ndryshme ligjore dhe procedurave administrative;
- **Fuqizimi i institucioneve dhe themelimi i organeve** – SNK-ja thekson nevojën e fuqizimit të disa institucioneve (Instituti për Mbrojtje të Natyrës, Shërbimi Meteorologjik, etj.). Këto intervenime duhet të jenë prioritare pasi paraqesin parakusht për implementimin e një numri të intervenimeve të propozuar nga SNK-ja.
- **Ofrimi i trajnimeve për profesionistë** – Ky veprim është mjaft gjithëpërfshirës, duke marrë parasysh llojet e ndryshme të trajnimeve dhe grupeve të synuara të nevojshme në fushëveprimin e implementimit të SNK-së. Përderisa disa hapa janë të njohur në mënyrë eksplicite përmes SNK-së, siç janë trajnimi për negociata sipas UNFCCC-së dhe BE-së respektivisht, trajnimi për menaxhimin efikas të ujitjes për fermerë, trajnimi për përshtatje në ndryshimet klimatike për profesionistë të avancuar për: ujëra, bujqësi, pylltari, planifikim të shfrytëzimit të tokës, shëndet publik dhe sektorë tjerë, hapat e tjerë me siguri do të dalin gjatë procesit të implementimit. Për të gjitha intervenimet rekomandohet të bëhet lista e trajnimeve të nevojshme, të përcaktohen prioritetet dhe të merren parasysh gjatë planifikimit të dinamikës së implementimit..
- **Menaxhimi dhe shkëmbimi i informatave** – me këtë titull në SNK (komponenti i përshtatjes) dallohen një grup veprimesh: fuqizimi i gjenerimit të përbashkët/me pjesëmarrje i informatave; modernizimi i sektorit të hidrometeorologjisë; përmirësimi i komunikimit (shkëmbimi i të dhënave dhe informatave të gjeneruara); përmirësimi i shfrytëzimit të informatave. Megjithatë, kjo është konsideruar si një intervenim i përbashkët (si për zbutje ashtu edhe për përshtatje) meqë themelimi i Sistemit Kombëtar të Inventarizimit nuk është i mundur pa përmirësimin e gjenerimit dhe shkëmbimit të informatave. Kjo me siguri do të kërkojë përmirësimin e statistikave zyrtare si dhe bashkëpunimin e shumë akterëve të ndryshëm.
- **Zhvillimi i strukturave të bashkëpunimit** – me këtë titull në SNK (komponentja e përshtatjes) dallohen një grup i veprimeve: fuqizimi i nivelit të pjesëmarrjes apo mundësive për pjesëmarrje të palëve të interesit; përmirësimi i bashkëpunimit ndër-sektorial; përmirësimi i bashkëpunimit ndërmjet niveleve administrative; përmirësimi i bashkëpunimit përtej kufijve administrativ. Ky është një shembull klasik i intervenimit administrativ që ka aplikim afatgjatë pasi që secili obligim i ri kërkon përshtatje administrative dhe rritje të bashkëpunimit ndërmjet palëve përgjegjëse. Për më tepër, mekanizmat e transparencës dhe pjesëmarrjes publike duhet të përmirësohen në mënyrë të vazhdueshme.

3.2.3 Investimet në infrastrukturë

Janë disa intervenime të cilat kërkojnë investime të mëdha në infrastrukturë. Duke marrë parasysh disponueshmëria e fondeve dhe fushëveprimin e intervenimeve, konsiderohen kryesisht si intervenime afatgjata, siç janë:

- Rritja e efijencës së gjenerimit të energjisë elektrike përmes zëvendësimit të TC Kosova A me Termocentralin Kosova e Re
- Reduktimi i rrjedhjeve në rrjetin shpërndarës të ujit të pijshëm
- Ri-kultivimi i vendeve industriale të mbetura
- Rindërtimi i hekurudhave
- Rritja e kapacitetit shkarkues të lumenjve.

3.2.4 Aktivitetet për ndërgjegjësimin e publikut

Një numër intervenimesh të propozuara me SNK kanë të bëjnë me aktivitete promovuese. Ato përfshijnë:

- Programet për ndërgjegjësim publik për ndryshimet klimatike dhe mënyrën e ballafaqimit me ndikimet e saj, duke përfshirë a) fushatën e ndërgjegjësimit për rreziqet e ndërtimit, të jetuarit dhe të punuarit në zona të cenueshme, b) fushatën e ndërgjegjësimit për ruajtjen e ujit për qytetarë, kompani, fabrika, etj.;
- Promovimin dhe ndërgjegjësimin për efijencën e energjisë;
- Promovimin e transportit publik rrugor;
- Promovimin e ecjes dhe çiklizmit;
- Promovimin e kompostimit shtëpiak;
- Promovimin e praktikave të mira bujqësore (ruajtjen e plehut të kafshëve, metodat e përgatitjes dhe aplikimit, aplikimin e duhur të mineraleve dhe plehrave organike);
- Promovimin e grumbullimit të ujërave të reshjeve;
- Programet e ndërgjegjësimit për punonjës të shëndetit publik dhe praktikuesit mjekësor për çështjet e ndryshimeve klimatike dhe shëndetit.

Poashtu, sikur se aktivitetet e trajnimit edhe aktivitetet promovuese duhet të planifikohen gjatë gjithë periudhës së mbuluar nga Plani i Veprimit, sipas prioriteteve të tyre. Megjithatë, fushatat në një medium të vetëm nuk mund të sjellin rezultate të konsiderueshme. Prandaj është e domosdoshme shpërndarja e aktiviteteve të ndërgjegjësimit publik në një periudhë më të gjatë kohore, duke përsëritur disa veprime për të rritur ndërgjegjësimin publik.

3.2.5 Intervenimet financiare dhe ekonomike

Intervenimet financiare dhe ekonomike ndërlidhen me instrumentet financiare si subvencionet apo tarifatat, taksat, stimulimet, etj. Për të krijuar pako adekuate të instrumenteve financiare patjetër duhet të bëhen analizat e kosto-benefitit të cilat iu tregojnë vendim-marrësve se instrumentet e planifikuara, siç janë stimulimet, mund të sjellin përfitime në periudhën afatgjatë, apo që taksat dhe tarifatat korrespondojnë me një nivel të caktuar të efekteve negative të ndryshimeve klimatike dhe nuk paraqesin një barrë të panevojshme për biznesin.

4 UDHËRRËFYESI PËR IMPLEMENTIM

Për të lehtësuar arritjen e qëllimeve të SNK-së, duke marrë për bazë objektivat strategjisë, intervenimet e propozuara dhe analizat e realizuara, të saj, është përpiluar ky udhërrëfyes, me qëllim, që të mundësoj planifikim më të mirë strategjik dhe financiar duke theksuar patjetër parakushtet, kufizimet ekzistuese dhe përpjekjet e nevojshme.

Për t'iu afruar vizionit të Kosovës reziliente ndaj klimës, e cila në mënyrë efektive zbutë shkaqet e ndryshimeve klimatike, SNK-ja ka dy komponente kryesorë: Komponentja për zhvillim me emetime të ulëta dhe Komponentja e Përshtatjes Kombëtare.

4.1 Intervenimet e përbashkëta të dy komponenteve të SNK-së

Siç u shpjegua më parë, analiza e intervenimeve të propozuara nga SNK-ja gjatë zhvillimit të këtij Planit të Veprimit ka treguar disa mbivendosje ndërmjet dy komponenteve të saj si dhe disa intervenimeve që mund të jenë me dobi për të dy komponentet. Për shkak të planifikimit, monitorimit dhe raportimit më të lehtë, këto intervenime do të trajtohen si të përbashkëta. Në përgjithësi, prioritet duhet t'i jepet këtyre grupeve të intervenimeve, pasi që shumica prej tyre kanë të bëjnë me krijimin e rrethanave të duhura të cilat do të mundësojnë implementimin e komponentëve të startegjisë.

4.1.1 Intervenimet e përbashkëta strategjike

1. Monitorimi dhe raportimi lidhur me zbatimin e SNK-së

- a. Hapi 1 – Caktimi i personelit përgjegjës për Monitorim dhe raportim lidhur me zbatimin e SNK-së
- b. Hapi 2 – Zhvillimi dhe miratimi i Raportit të parë për zbatimin e SNK-së
- c. Hapi 3 - Zhvillimi dhe miratimi i Raportit të dytë për zbatimin e SNK-së
- d. Hapi 4 – Rishikimi i Planit të Veprimit nëse është e nevojshme
- e. Hapi 5 – Zhvillimi dhe miratimi i Raportit Përfundimtar për zbatimin e SNK-së
- f. Hapi 6 – Rishikimi i SNK-së dhe zhvillimi i PV-së për periudhën pas vitit 2014.

2. Integrimi i objektivave të SNK-së në dokumentet relevante strategjike/politikat sektoriale

- a. Hapi 1 – Futja e objektivave të SNK-së në PKVM-në pas vitit 2017 dhe në Strategjinë dhe Planin e Veprimit për biodiversitet të pas vitit 2020
- b. Hapi 2 – Futja e objektivave të SNK-së në Planin e Veprimit për Eficiencë të Energjisë (PKEE) të pas vitit 2018, Strategjinë për Ngrohje dhe Strategjinë për Energji
- c. Hapi 3 – Futja e objektivave të SNK-së në Planin Kombëtar të Veprimit për Energji të Ripërtëritshme (PKVER) të pas vitit 2020
- d. Hapi 4 – Futja e objektivave të SNK-së në Planin Kombëtar për Menaxhimin e Thatësirave (PKMTH)
- e. Hapi 5 – Futja e objektivave të SNK-së në Politikën për Mbrojtje të Pyjeve
- f. Hapi 6 - Futja e objektivave të SNK-së në Politikën për Mbrojtje të Shëndetit
- g. Hapi 7 – Futja e objektivave të SNK-së në Planin Strategjik për Menaxhimin e Mbeturive (PSMM) dhe planet komunale për menaxhimin e mbeturive
- h. Hapi 8 – Futja e objektivave të SNK-së në Strategjinë për menaxhimin e ujërave tokësore (apo objektivat për menaxhimin e ujërave tokësore të integruara në dokumentet tjera sektoriale strategjike)

3. Implementimi i Planit Kombëtar të Veprimit për Mjedis (PKVM) për periudhën 2013-2017

- a. Hapi 1 – Monitorimi dhe përmirësimi i implementimit të PKVM-së ekzistuese

Objektivi kryesor i këtij Plani të Veprimit është që të lehtësojë implementimin, monitorimin dhe raportimin për SNK-në. Prandaj, hapat kyç që lidhen me këtë proces janë paraqitur këtu si intervenimi më i rëndësishëm me prioritetin më të lartë. Plani më i detajuar i monitorimit është ofruar në Kapitullin 6.

Objektivi i parë specifike i këtij Plani të Veprimit është që të sigurojë integrimin e politikës kombëtare për ndryshime klimatike në politikat e sektorëve relevant, qofshin ato ekzistuese apo të planifikuara që të zhvillohen në pajtueshmëri me objektivat e SNK-së.

Implementimi i PKVM-së konsiderohet si masë e përbashkët, pasi që në SNK propozohet caktimi dhe zhvillimi i fushave të mbrojtura (që mund të jenë të lidhura me mbrojtjen e pyjeve dhe rritjen e rezervuarëve të GS-ve sipas komponentes për zhvillim me emetim të ultë dhe korridoreve ekologjike sipas komponentes për përshtatje. Sipas Raportit të Progresit për Kosovën të BE-së³, „është bërë shumë pak progres në fillimin e krijimit të rrjetit Natura 2000 të zonave të mbrojtura. Institucionet në këtë fushë mbesin të dobëta”. Prandaj, veprimet e mëtejme të propozuara në SNK që lidhen me krijimin e zonave të mbrojtura dhe korridoreve ekologjike, fuqizimin e Institutit për Mbrojtjen e Natyrës dhe futjen e kriterëve të biodiversitetit në planifikimin hapësinor duhet të integrohen në PKVM-në e pas vitit 2017.

4.1.2 Intervenimet e përbashkëta administrative

SNK identifikon shumë intervenime administrative, posaçërisht në komponenten e përshtatjes, të cilat synojnë përmirësimin e menaxhimit dhe shkëmbimit të informatave, zhvillimin e strukturave të bashkëpunimit, përmirësimin e mekanizmave për transparencë dhe pjesëmarrje publike si dhe fuqizimin e rregullimit institucional. Intervenimet në vijim janë konsideruar me dobi për të dy komponentet:

1. Përmirësimi i krijimit të informatave, shfrytëzimit të informatave dhe komunikimit

- a. Hapi 1 - Zhvillimi i veglave të teknologjisë informative dhe procedurave administrative për mbledhje dhe shkëmbim të dhënash
- b. Hapi 2 – Fuqizimi i nivelit të pjesëmarrjes së palëve të interesit në vendim-marrje lidhur me ndryshimet klimatike
- c. Hapi 3 – Përmirësimi i bashkëpunimit ndër-sektorial
- d. Hapi 4 –Përmirësimi i bashkëpunimit ndërmjet niveleve administrative
- e. Hapi 5 –Përmirësimi i bashkëpunimit përtej kufijve administrativ

2. Trajnimi i profesionistëve (lista e propozuar mund të zgjerohet)

- a. Hapi 1 - Trajnimi për ndryshime klimatike për profesionistët e avancuar për ujëra, bujqësi, pylltari, planifikim të shfrytëzimit të tokave, shëndet publik, etj.
- b. Hapi 2 – Trajnimi për përdorimin e mirëfilltë të objekteve dhe pajisjeve të ndërlidhura për trajtimin e plehut organik
- c. Hapi 3 – Trajnimi për implementimin e GIS dhe integrimi i sistemit të bazës së të dhënave
- d. Hapi 4- Trajnimi për menaxhimin eficient të ujitjes për fermerë
- e. Hapi 5- Trajnimi për negociatat për klimën sipas UNFCCC-së respektivisht BE-së

³ Dokument pune i personelit të Komisionit Raporti për Kosovën*

http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2015/20151110_report_kosovo.pdf

3. Themelimi i grupit punues ndër-qeveritar të institucioneve përgjegjëse për mbrojtjen e pyjeve

- a. Hapi 1 – Krijimi i planit të punës së grupit punues ndër-qeveritar bazuar në Formularin Nr. 8 të intervenimeve të komponentës për zhvillim me emetim të ultë dhe Formularin e intervenimeve Nr. 16 të komponentës për përshtatje.

Patjetër duhet të themelohen mekanizmat për shkëmbim funksional të informatave ndërmjet organeve administrative. Kjo është jetike për implementimin e një numri të intervenimeve të parapara me SNK (krijimi i sistemit kombëtar të inventarizimit, krijimi i platformës për zvogëlim të rrezikut, etj.), por gjithashtu për grumbullimin e informatave për implementimin e intervenimeve të ndryshme të SNK-së në sektorë të ndryshëm dhe implementimin e politikave dhe dokumenteve strategjike të sektorëve relevant.

Poashtu, është me dobi të avancohet bashkëpunimi në të gjitha nivelet në kontekstin e ndryshimeve klimatike ku hapat e para ndër lidhen me identifikimin e institucioneve dhe personelit përgjegjës për çështjet rreth ndryshimeve klimatike.

Aktivitetet e ngritjes së kapaciteteve mbështeten në trajnimin e profesionistëve të fushave të ndryshme. Aktivitetet e trajnimit gjithnjë duhet të përcillen me veprime plotësuese. Duke marrë parasysh kapacitetin absorbues të administratës publike, duhet të përpilohet një plan i përpiktë i trajnimit të personelit së paku në baza vjetore. Poashtu, duhet të merret në konsideratë financimi i aktivitete trajnuese përmes programeve të dedikuara (p.sh. EU TAIEX, ECRAN, aktivitetet tjera të donatorëve).

4.1.3 Intervenimet për ndërgjegjësim publik

SNK-ja në të dy komponentët e saj rekomandon një numër të aktiviteteve për ndërgjegjësim publik. Edhe pse në dy komponentet e saj mbulohen tema të ndryshme, ndërgjegjësimi i përgjithshëm i publikut për ndryshimet klimatike dhe ndikimet e tyre është i domosdoshëm për të kuptuar dhe pranuar aktivitetet e promovuara. Në përgjithësi, pothuajse të gjitha intervenimet e SNK-së, e posaçërisht ato që lidhen me paraqitjen e koncepteve dhe mekanizmave të ri, kanë nevojë për aktivitete të caktuara të ndërgjegjësimit publik. Objektivi kryesor i aktiviteteve të ndërgjegjësimit publik për ndryshimet klimatike është të arrihet ndryshim gradual i sjelljeve për të përvetësuar mënyra më të qëndrueshme të stilit të jetës. Prandaj, ekziston nevoja për një program afatgjatë për të mbuluar tema të ndryshme të përcjelluara me veprimet e duhura. Si dhe rekomandohet zhvillimi i një bashkëpunimit afatgjatë me mediat (gazetat, radiot, TV-të, mediat sociale) dhe një kontributi javor me artikuj për të promovuar teknikat e ndryshme të zvogëlimit apo përshtatjes siç janë kursimi i ujit, ecja dhe çiklizmi, eficientia e energjisë, etj.

1. Planifikimi i aktiviteteve të ndërgjegjësimit publik (lista e propozuar mund të pasurohet edhe me hapa të tjerë)

- Hapi 1 - Fushatë për ndërgjegjësim publik për ruajtjen e ujit dhe grumbullimin e ujit nga reshjet
- Hapi 2 - Programe për ngritje të ndërgjegjësimit të personelit mjekësor për ndikimet negative të ndryshimeve klimatike
- Hapi 3 – Promovimi i transportit rrugor publik, promovimi i ecjes dhe çiklizmit

- Hapi 4 - Promovimi i praktikave të mira bujqësore (ruajtja e plehut organik, metodat e përgatitjes dhe aplikimit, aplikimi i mirëfilltë i plehrave minerale dhe atyre organike, kompostimi shtëpiak)
- Hapi 5 - Planifikimi i veprimeve tjera për ndërgjegjësim publik, duke shfrytëzuar ngjarje dhe raste të veçanta për aktivitete të PV-së

4.1.4. Intervenimet financiare dhe ekonomike

SNK-ja propozon intervenime të ndryshme financiare dhe ekonomike siç janë taksat, stimulimet dhe promovimi i partneriteteve publiko-private. Përderisa instrumentet e veçuara mund të jenë efikase deri në kufij të caktuar, pakot fiskale të planifikuara në mënyrë strategjike me siguri do të japin rezultate bindshëm më efektive. Për shembull, kërkesa për të kushtëzuar prokurimin me kushte për gjelbërim mund të ndihmojë në përmirësimin e autoparqeve, që pajisje dhe ndërtesa të janë eficiente në energji dhe të arrihen efekte të shumëfishta në zhvillimin me emetime të ulëta edhe në përshtatje.

1. Zhvillimi i pakos së taksës klimatike

- a. Hapi 1 - Realizimi një studimi të fizibilitetit për mundësit për të stimuluar përmes taksave si dhe tarifave të cilat janë në të mirë të klimës. Këtu duhet marrë në parasysh [përvojat](#) ndërkombëtare dhe rrethanat ekonomike vendore
- b. Hapi 2 - Ndryshimi i kornizës ligjore
- c. Hapi 3 - Monitorimi dhe vlerësimi i efekteve të intervenimeve financiare dhe ekonomike

4.2 Zhvillimi me emetime të ulëta

Komponentja e zhvillimit me emetime të ulëta përqëndrohet në dy objektiva:

- Të ngritjen kapacitetet për të përmbushur detyrimet e ardhshme sipas UNFCCC dhe BE-së;
- Të bëhet ngadalësimi i rritjes së emetimeve të GS-ve duke shtuar në të gjithë sektorët eficiencën e energjisë, zhvilluar burimet e energjisë së ripërtëritshme dhe shfrytëzuar në mënyrë të qëndrueshëm të resurseve natyrore.

Planifikimin strategjik për të ulur emetimet, e bën më të vështirë mungesa e të dhënave dhe parashikimeve për emetimet e GS-ve . Kjo gjë ndikon në mënyrë negative për të ngritur fondet dhe investimet buxhetore. Prandaj, kjo komponente është e përqëndruar për të ngritur kapacitetet dhe përmirësuar kornizën strategjike, duke pranuar intervenimet në sektorët ku emetimet e GS-ve mund të reduktohen apo të rriten rezervuarët e GS-ve.

4.2.1. Intervenimet strategjike të KZHEU-së

Ndër intervenimet “strategjike” të KZHEU-t, të cilat synojnë përmirësimin dhe avancimin e implementimit të kësaj kornize strategjike, janë identifikuar veprimet dhe hapat në vijim:

1. Zbatimi i Planit të Veprimit të Kosovës për Eficiencë të Energjisë 2010-2018
 - a. Hapi 1 – Monitorimi dhe përmirësimi i zbatimit të PKEE-së ekzistuese
2. Zbatimi i Planit Kombëtar të Veprimit të Energji të Ripërtëritshme (PKVER 2011 -2020)

- a. Hapi 1 - Monitorimi dhe përmirësimi i zbatimit të PKVER-it ekzistues
- 3. Zhvillimi i kornizës strategjike për menaxhimin e mbeturinave**
- a. Hapi 1 – Zhvillimi i Planit Strategjik për Menaxhimin e Mbeturinave (PSMM)
 - b. Hapi 2 – Zhvillimi i planeve komunale për menaxhimin e mbeturinave në pajtueshmëri me PSMM-në
 - c. Hapi 3 – Realizimi i studimit të fizibilitetit për bashkë-përpunim të mbeturinave në industri

Këto veprime dhe hapa janë formuluar mbi bazën e kornizës ekzistuese strategjike me bindjen se nëse këto intervenime janë paraparë edhe me politikat e sektorëve të tjerë relevant, nuk do të duhej të përsëriten në këtë PV. Pra, duhettë shmanget dyfishimi i intervenimeve dhe veprimeve si dhe dyfishimi i përgjegjësi. Për më shumë, integrimi i politikave për klimën në ato sektoriale është parakushti kryesor për implementimin e strategjisë për shkak të natyrës së saj ndër-sektoriale.

Sipas raportit vjetor të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë (të publikuar më 1 shtator 2015)⁴ Kosova ishte Pala e parë Kontraktuese e EE-së e cila ka dorëzuar draftin për PVEE-në e dytë, i cili është miratuar në dhjetor të vitit 2013. Ai është i një cilësie shumë të mirë dhe propozon pako adekuatë të intervenimeve për eficiencë të energjisë në të gjithë sektorët. Ai përfshin një analizë dhe vlerësim të detajuar të PVEE-së së parë dhe raportin për kursimet e energjisë dhe përmbushjen e synimit të ndërmjetëm (32 ktoe apo 3% në vitin 2012). Sektorët e ekonomive familjare dhe transportit, të cilët në përgjithësi përbëjnë konsumin më të lartë të energjisë, janë trajtuar si duhet në PVEE-në e dytë përmes intervenimeve të ndryshme për eficiencë të energjisë. Duke marrë këtë parasysh, edhe se PKEE-ja ekzistuese është e kufizuar në afatin kohor deri në vitin 2018, si dhe Strategjinë Kombëtare për Ngrohje dhe Strategjinë për Energji, PV-ja rekomandon futjen e objektivave të SNK-së në këto instrumente strategjike kur ato do të rishikohen pas vitit 2018. Ndërsa intervenimet të cilat janë mbuluar me kornizat ekzistuese strategjike⁵ nuk janë shtjelluar më tej në këtë PV.

E njëjta gjë vlen edhe për zbatimin e PKVER-it, i cili prek tre sektorë: gjenerimin e energjisë elektrike, transportin dhe sektorin e ngrohjes e ftohjes.

Hapat e parë të intervenimit për menaxhim të mbeturinave, duhet patjetër të përfshihen në objektivave strategjike për ndryshime klimatike në politikat e sektorit të mbeturinave. Ndërsa, hapi i tretë i këtij intervenimi dhe arritja e objektivit si është përcaktuar në SNK (përdorimi i mbeturinave të ngurta jo të rrezikshme si karburant alternativ) mund të jetë në kundërshtim me objektivat tjera mjedisore siç është shkalla e riciklimit dhe cilësia e ajrit. Këto çështje patjetër duhet të merren në konsideratë, pasi që në procesin e integritimit në BE, shteti kandidat duhet të përmbushë standardet e cilësisë së ajrit si dhe të shkallës së riciklimit të përcaktuara nga BE-ja. Për më tepër, intervenimet tjera të parapara nga SNK-ja në sektorin e mbeturinave (p.sh. ndërtimi i infrastrukturës së ndarë për grumbullim të mbeturinave dhe riciklim) duhet të integrohen në politikën për menaxhimin e mbeturinave në mënyrë që të shmanget dyfishimi i përpjekjeve.

⁴Raporti i implementimit vjetor i Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë (Publikuar më 1 shtator 2015)
https://www.energycommunity.org/portal/page/portal/ENC_HOME/DOCS/3872267/23B450386A075E64E053C92FA8C0F69F.PDF

⁵ Intervenimet si promovimi dhe ngritja e vetëdijes për eficiencë të energjisë, përmirësimi i eficiencës së TC-ve ekzistues, rindërtimi dhe zgjerimi i rrjetit të ngrohjes qendrore, futja e energjisë së ripërtëritshme në gjenerim të energjisë, themelimi i sistemit të auditimit energjetik, etj.

4.2.2. Intervenimet administrative të KZHEU-së

Intervenimi kryesor (administrativ) i KZHEU-së për ngritje të kapaciteteve ndërlidhet me krijimin e Sistemit Kombëtar të Inventarizimit dhe "sistemeve për politika dhe masa e parashikime" sipas Nenit 3 (2) dhe (15) të Rregullores së BE-së Nr. 525/2013 për mekanizmin për monitorim dhe raportim të emetimeve të gazrave serë dhe për raportimin e informatave tjera relevante për ndryshimet klimatike. Është me rëndësi të krijohen kapacitetet dhe struktura për vlerësimin e potencialit të zvogëlimit. Edhe pse Kosova ende nuk ka obligime për raportim, ekziston nevoja për përmirësim të dhënave për GS-të në mënyrë që të mundësohet planifikim më i përshtatshëm në këtë fushë, siç është shpjeguar më lartë.

1. Krijimi i Sistemit Kombëtar të Inventarizimit dhe fuqizimit të raportimit për GS

- a. Hapi 1 – Futja e kërkesave kryesore të Rregullores së BE-së 525/2013 në kornizën ligjore kombëtare
- b. Hapi 2 – Emërimi i personelit përgjegjës për krijimin dhe mirëmbajtjen e inventarizimit të GS-ve
- c. Hapi 3 – Emërimi i personelit për parashikime të emetimeve
- d. Hapi 4 – Përditësimi dhe mirëmbajtja e rregullt e inventarizimit të GS-ve

2. Shfrytëzimi i pajisjeve për parandalimin e vetë-ndezjes së linjtit

Krijimi i Sistemit Kombëtar për Inventarizim është shtjelluar në Faqen Nr. 1 të Intervenimit të KZHEU-së, me kohën e parashikuar për investime në periudhën 2014-2020. Sidoqoftë, duke marrë parasysh fakti se Kosova ende nuk ka obligim formal ndërkombëtar për të raportuar për GS-të, si dhe fakti se sipas Rregullores së BE-së Nr. 525/2013, patjetër dhe në vazhdimësi duhet të rritet cilësia e të dhënave dhe Sistemit Kombëtar të Inventarizimit. Ky është aktivitet afatgjatë që është i ndërlidhur ngushtë me përmirësimin e menaxhimit dhe shkëmbimit të informatave.

Duke marrë parasysh se pajisjet për zjarrfikje në mihje janë blerë që në vitin 2005/2006, është e nevojshme të shfrytëzohen këto pajisje sa më shpejt që është e mundur. Intervenimi do të kontribuojë në reduktimin e GS-ve të emetuara nga vetë-ndezja e linjtit.

4.2.3. Intervenimet e KZHEU-së të ndërlidhura me investimet në infrastrukturë

1. Rritja e efijencës së gjenerimit të energjisë elektrike përmes zëvendësimit të TC Kosova A me termocentralin Kosova e Re

- a. Hapi 1 – Zhvillimi i dokumentacionit të nevojshëm të projektit dhe kontraktimi
- b. Hapi 2 – Fillimi i ndërtimit dhe punët ndërtimore

2. Rindërtimi i hekurudhave

3. Zhvillimi i pilot projektit (ve) të EU CIVITAS

SNK-ja identifikon disa projekte infrastrukture të cilët në mënyra të ndryshme do të adresonin efektet e ndryshimeve klimatike. Megjithatë, investimet më të konsiderueshme për reduktimin e emetimit të GS-ve ndërlidhen me sektorët e energjisë dhe transportit të cilat konsiderohen kontribuesit kryesor për emetimet e GS-ve në Kosovë.

Sa i përket ndërtimit të termocentralit të ri, Hapi i veprimit 1 përfshinë të gjitha dokumentet e nevojshme para ndërtimit të TC-së, duke përfshirë planet hapësinore, VNM-në dhe PKRE-në (Planin Kombëtar për Reduktim të Emetimeve) për Direktivën Centralet e Mëdha me Djegie (CMD). Kosova ka dy centrale që bien në fushëveprimin e Direktivës për Centralet e Mëdha me Djegie me gjithsej 5 njësi dhe input nominal total të nxehtësisë prej 3,350 MW. Të gjitha njësitë funksionojnë me linjit. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor duhet të vendos kornizën kohore sipas së cilës KEK-u duhet të përmbushë të gjitha obligimet që lidhen me reduktimin e emetimeve nga CMD-të. Kosova aktualisht është duke bërë matje të emetimeve në dy centralet e saj të mëdha me djegie, TC Kosova A (tri njësi) dhe TC Kosova B (dy njësi) si parakusht për përgatitjen e Planit Kombëtar për Reduktimin e Emetimeve. Realizimi i këtij projekti të madh investiv (që vlerësohet në 1,2 miliard EUR 2x300MW) do të varet nga disponueshmëria e fondeve/investitorëve, por meqenëse modernizimi i gjenerimit të energjisë është detyrim, hapat përgatitorë duhen ndërmarrë me prioritet në mënyrë që të mundësohet planifikim më i mirë financiar dhe si mbështetje në gjetjen e fondeve/investitorëve.

Rrjeti hekurudhor i Kosovës përbëhet nga 334,451 km për transport publik dhe 103,4 km për përdorim industrial. Transporti hekurudhor përdor naftën si burim të energjisë. Hekurudha nuk është plotësisht në funksion dhe ka nevojë për modernizim gradual. Kostot nuk janë vlerësuar.

SNK-ja rikthehet te programi EU CIVITAS. Gjatë dhjetë viteve të fundit CIVITAS ka arritur të testojë mbi 800 intervenime dhe zgjidhje të transportit urban.⁶ Edhe nëse projektet për transport të qëndrueshëm nuk implementohen në kuadër të programit EU CIVITAS, baza e të dhënave për intervenimet e testuara duhet të përdoret në mënyrë që të gjenden zgjidhjet e përshtatshme të testuara në praktikë.

4.3 Komponentja e Përshtatjes Kombëtare

Komponentja e Përshtatjes e SNK-së formulon tri objektiva:

- Paraqitja e mekanizmave të ri dhe përmirësimi i mekanizmave ekzistues për zvogëlim të rrezikut nga fatkeqësitë
- Përmirësimi i kapacitetit të përshtatjes së sistemeve natyrore
- Ngritja e kapaciteteve

Kjo komponentë e SNK-së është shtjelluar më në hollësi, gjë që ka rezultuar me intervenime të shumta. Analiza e intervenimeve të propozuara e përdorur për këtë komponent është bazuar në qasjen e njëjtë sikur për KZHEU, duke synuar shmangien e dyfishimit të përpjekjeve dhe shmangien e barrës së panevojshme administrative.

4.3.1. Intervenimet strategjike të KPK-së

Përveç intervenimeve strategjike të përbashkëta që lidhen me të dy komponentët e SNK-së (KZHEU dhe PKP), komponentja i përshtatjes identifikon intervenimet strategjike në vijim:

1. Zhvillimi i Platformës për Menaxhim të Rrezikut
2. Zvogëlimi i rrezikut nga përmytjet

⁶ <http://www.civitas.eu/about-us-page>

- a. Hapi 1 – Krijimi i bazës së të dhënave për regjistrin e rrjedhave lumore
- b. Hapi 2 – Hartëzimi i zonave të prirura për përmytje
- c. Hapi 3 – Zhvillimi i planeve për menaxhimin e rrezikut nga përmytjet – në mbarë Kosovën

3. Përgatitja e Draft Planit Kombëtar për Menaxhimin e Thatësirave (PKMTH)

4. Zhvillimi i planeve të menaxhimit të ujërave tokësore

5. Intervenimet që lidhen me shëndetin publik

- a. Hapi 1 – Realizimi i Vlerësimit të Cenueshmërisë në Ndikimin në Shëndet
- b. Hapi 2 – Zhvillimi i planit të përshtatjes për sektorin shëndetësor

SNK-ja përshkruan gjendjen në lidhje me zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë në mënyrën në vijim: “Departamenti për Menaxhimin e Emergjencave (DME) në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme është formalisht përgjegjës për koordinimin dhe/ose kryerjen e vlerësimeve të dëmeve. Mbledhja dhe ruajtja e të dhënave është ad hok. Në vitin 2009 është realizuar Vlerësimi i Rrezikut për Kosovën i cili ka mbuluar të gjitha rreziqet potenciale për popullatën e Kosovës dhe është bërë përpjekje të bëhet kuantifikimi i nivelit të pritur të dëmit. Vlerësimi fokusohet kryesisht në rreziqet dhe cenueshmëritë strukturore, ndërkaq të dhënat e cenueshmërisë ndaj ndryshimeve klimatike për Kosovën nuk janë në dispozicion. “Prandaj, për të arritur objektivin primar të komponentes KPK, është me rëndësi të vlerësohet cenueshmëria ndaj ndryshimeve klimatike në sektorët më të cenueshëm (ujërat, bujqësia, biodiversiteti, pylltaria, shëndeti) dhe të krijohet platforma e përshtatshme për zvogëlim të rrezikut si dhe mekanizmat për zvogëlim të rrezikut.

Meqë përmytjet konsiderohen si kërcënim madhor që ndërlidhen me ndryshimet klimatike, duhet një qasje e ndarë strategjike për reduktimin e rreziqeve nga përmytjet. Në vend të politikave në nivel kombëtar, planet lokale për menaxhimin e rrezikut janë shumë më efektive kur merren në konsideratë terrenet e ndryshme, organet për ujëra dhe madhësia e popullatës së rrezikuar.

Plani kombëtar për menaxhimin e thatësirave duhet të përfshijë një numër të intervenimeve të propozuara nga SNK-ja, siç janë teknologjitë për kursimin e ujit në sisteme të ujitjes, përzgjedhja e farërave të kulturave bimore me qëndrueshmëri të lartë, siguri i rrjedhës minimale në periudha të thata, politika për kalimin e ujit, ndërtimi i zonave mbajtëse, etj.

Varësisht nga gjendja aktuale në sektorin e ujit, ekziston nevoja e identifikuar nga SNK-ja për zhvillimin e strategjisë specifike për menaxhimin e ujërave tokësore. Nëse është më e përshtatshme ky dokument strategjik mund të inkorporohet në strategjinë kornizë për sektorin e ujërave.

4.3.2. Intervenimet administrative për KPK

Si është shpjeguar në Kapitullin 3, intervenimet administrative janë të ndërlidhura me funksionimin e administratës publike dhe shpesh paraqesin parakusht për zhvillimin e mirëfilltë të politikave. Për shembull, korniza e përshtatshme ligjore dhe institucionale paraqet faktor kyç për intervenimet për përshtatje që lidhen me temat në vijim:

- 1. Hartimi dhe miratimi i Ligjit të ri për Ndërtimet**
- 2. Hartimi i standardeve dhe udhëzimeve ndërtimore për ndërtesa të gjelbra dhe kulme të gjelbra**
- 3. Zhvillimi dhe miratimi i akteve të nevojshme ligjore dhe VNM-së që lidhen me kalimin e ujërave**
- 4. Zhvillimi i akteve të nevojshme ligjore për shfrytëzimin dhe mbrojtjen e ujërave tokësore**

Për të siguruar se planet zhvillimore urbane do të shfrytëzojnë zonat urbane në mënyrë më racionale e funksionale dhe që të synojnë parandalimin e ndërtimeve të pakontrolluara dhe zhvillimin e vendbanimeve në zona të rrezikshme, është e nevojshme që të ndryshohet ligji për ndërtimet, futja e intervenimeve tjera të SNK-së, siç janë promovimi i standardeve të gjelbra në ndërtimtari, përfshirja e objektivave për biodiversitet lokal në planifikim, ofrim dhe menaxhim të intervenimeve për infrastrukturë të gjelbër, etj.

Poashtu nevojiten intervenimet ligjore për promovimin e mekanizmave për përmirësimin e kapacitetit të përshtatjes siç janë kulmet e gjelbra, kalimi i ujit, mbrojtja e ujërave tokësore, etj.

4.3.3. Intervenimet për KPK që ndërlidhen me investime në infrastrukturë

Reduktimi i rrezikut dhe dëmit nga ndikimet aktuale dhe të ardhshme të ndryshimeve klimatike dhe avancimi i kapacitetit të përshtatjes kërkon shumë investime në infrastrukturë. SNK-ja identifikon fusha të ndryshme të intervenimeve që fokusohen në futjen në funksion të mekanizmave të reja dhe përmirësimin e atyre ekzistues për zvogëlim të rrezikut.

1. Modernizimi i rrjeteve monitoruese hidrometeorologjike

- a. Modernizimi i rrjetit ekzistues të monitorimit të resurseve ujore
- b. Modernizimi dhe zgjerimi i rrjetit meteorologjik ekzistues

2. Zvogëlimi i rrjedhjeve në rrjetin shpërndarës të ujit të pijes

3. Rikultivimi i vendeve të mbetura industriale

- a. Zhvillimi i studimeve të fizibilitetit, VNM-së, dizajnit të projektit dhe dokumentacionit për planifikimin hapësinor për vendet industriale të mbetura në Parkun Industrial në Mitrovicë, Stari Trg dhe Zveçan
- b. Implementimi i masave të rehabilitimit
- c. Ndërtimi i impiantit për trajtim për ujërat acidike nga miniera

4. Rritja e kapacitetit të shkarkimit të lumenjve

- a. Thellimi i shtretërve të lumenjve gjatë verës
- b. Rregullimi apo largimi i pengesave hidraulike në shtratin e lumit
- c. Rregullimi i fushës lymore
- d. Zëvendësimi i digave për të rritur kapacitetin e shtratit të lumit

5. Zhvillimi i pilot projektit (ve) "kulmi i gjelbër"

6. Zhvillimi i pilot projekteve për reklamacionin e ujit

- a. Hartëzimi dhe përzgjedhja e vendeve industriale, objekteve institucionale dhe/ose të banimit të cilat janë të përshtatshme për implementimin e pilot projekteve
- b. Realizimi i studimeve të fizibilitetit dhe dizajneve të projekteve për vendet e përzgjedhura për reklamacion të ujit
- c. Implementimi i teknologjive të përshtatshme të riciklimit për vendet e përzgjedhura për reklamacion të ujit

7. Zhvillimi i dizajnit të masave rehabilituese për të siguruar integritetin strukturor të hidro-sistemit Ibër-Lepenci

8. Zhvillimi i dizajnit për impiantin për trajtim të ujërave acidike të shkarkuara (Miniera e Novobërdës)

SNK-ja vlerëson që modernizimi i shërbimeve hidrometeorologjike në Kosovë do të kushtonte rreth 20-30 milion €. Para se të bëhet një investim i tillë, duhet themeluar korniza e mirëfilltë institucionale si në nivelin qendror ashtu edhe në atë lokal dhe duhet siguruar trajnimi i personelit kyç.

Duke marrë parasysh që sipas SNK-së, vlerësimet për intervenimet e listuara do të kushtonin më shumë se 150 milion €, përcaktimi i prioriteteve dhe afateve kohore dhe marrja e zotimeve për implementim është detyrë që kërkon mjaft shumë. Prandaj, ky grup i intervenimeve duhet të implementohet hap pas hapi, duke u siguruar që punët përgatitore (si dokumentacioni teknik, korniza legjislative, rregullimi institucional, etj.) janë kompletuar para fillimit të projektit. Gjithashtu, pasi shumica e intervenimeve të listuara duhet të implementohen në mbarë Kosovën, disa intervenime do të mund të kryhen në mënyrë graduale (p.sh. rindërtimi i rrjetit të shpërndarjes së ujit apo rehabilitimi i shtretërve të lumenjve) apo pjesërisht, komunë pas komune. Kjo gjithashtu nxjerr në pah nevojën që këto masa të konsiderohen afatgjata dhe në disa raste mund të përfundohen pas përfundimit të afatit të këtij Plani të Veprimit.

5 PLANI I VEPRIMIT

5.1 Masat e vazhdueshme (2016-2024)

1. Monitorimi dhe raportimi lidhur me zbatimin e SNK-së

Lloji i intervenimit: Intervenim strategjik		Sektori: Ngritja e kapaciteteve		
Objektivi: Politikat kombëtare për ndryshimet klimatike të zhvilluara dhe të zbatuara				
Hapi i veprimit 1: Caktimi i personelit përgjegjës për monitorim dhe raportim lidhur me zbatimin e SNK-së				
Institucioni përgjegjës	Afati kohor	Resurset nevojshme e	Sfidat mundshme e	Rezultati
MMPH	2016 (Tremujori i IV-të)	N/A		Monitorimi dhe raportimi i rregullt
Hapi i veprimit 2: Zhvillimi dhe miratimi i raportit të parë lidhur me zbatimin e SNK-së				
Institucioni përgjegjës	Afati kohor	Resurset nevojshme e	Sfidat mundshme e	Rezultati
MMPH	2018 (Tremujori i IV-të)	N/A		Publiku i informuar për fazën fillestare të zbatimit të SNK-së
Hapi i veprimit 3: Zhvillimi dhe miratimi i raportit të dytë lidhur me zbatimin e SNK-së				
MMPH/personi apo grupi përgjegjës	2021 (Tremujori i IV-të)	N/A	N/A	Publiku i informuar për fazën fillestare të zbatimit të SNK-së
Hapi i veprimit 4: Rishikimi i Planit të Veprimit nëse është e nevojshme				
Institucioni përgjegjës	Afati kohor	Resurset nevojshme e	Sfidat mundshme e	Rezultati
MMPH/personi apo grupi përgjegjës GPNM	2022 (Tremujori i I-rë)	N/A	N/A	Plani i Veprimit i përditësuar me ricaktim të orareve për masat që nuk janë zbatuar siç është planifikuar
Hapi i veprimit 5: Zhvillimi dhe miratimi i raportit të tretë lidhur me zbatimin e SNK-së				
Institucioni përgjegjës	Afati kohor	Resurset nevojshme e	Sfidat mundshme e	Rezultati
MMPH/personi apo grupi përgjegjës	2024 (Tremujori i I-rë)	N/A	N/A	Publiku i informuar për fazën fillestare të zbatimit të SNK-së
Hapi i veprimit 6: Rishikimi i SNK-së dhe zhvillimi i PV-së të pas vitit 2024				
Institucioni përgjegjës	Afati kohor	Resurset nevojshme e	Sfidat mundshme e	Rezultati

MMPH/personi apo grupi përgjegjës	2024 (Tremujori i I-rë)	N/A	N/A	SNK-ja dhe Plani i Veprimit të përditësuar
-----------------------------------	-------------------------	-----	-----	--

2. Integrimi i objektivave të SNK-së në dokumentet relevante strategjike/politikat sektoriale

Lloji i masës: Masat strategjike		Sektori: të gjitha		
Objekti: Monitorimi i objektivave të SNK-së të integruara në dokumentet tjera strategjike/politikat sektoriale				
Hapi i veprimit 1: Futja dhe monitorimi i zbatimit të objektivave të SNK-së në PKVM të pas vitit 2017 dhe në Strategjinë dhe Planin e Veprimit për biodiversitet të pas vitit 2020				
Institucioni përgjegjës	Afati kohor	Resurset nevojshme	Sfidat mundshme	Rezultati
MMPH/personi apo grupi përgjegjës	2016 - 2024	N/A	N/A	Monitorimi i rregullt i zbatimit të objektivave të SNK-së
Hapi i veprimit 2: Futja dhe monitorimi i zbatimit të objektivave të SNK-së në Planin e Veprimit për Eficiencë të Energjisë (PKEE) të pas vitit 2018, Strategjinë për Ngrohje dhe Strategjinë për Energji				
MMPH/personi apo grupi përgjegjës	2016 - 2024	N/A	N/A	Monitorimi i rregullt i zbatimit të objektivave të SNK-së
Hapi i veprimit 3: Futja dhe monitorimi i zbatimit të objektivave të SNK-së në Planin Kombëtar të Veprimit për Energji të Ripërtëritshme (PKVER) të pas vitit 2020				
Institucioni përgjegjës	Afati kohor	Resurset nevojshme	Sfidat mundshme	Rezultati
MMPH/personi apo grupi përgjegjës	2016 - 2024	N/A	N/A	Monitorimi i rregullt i zbatimit të objektivave të SNK-së
Hapi i veprimit 4: Futja dhe monitorimi i zbatimit të objektivave të SNK-së në Planin Kombëtar për Menaxhimin e Thatësirave (PKMTH)				
Institucioni përgjegjës	Afati kohor	Resurset nevojshme	Sfidat mundshme	Rezultati
MMPH/personi apo grupi përgjegjës	2016 - 2024	N/A	N/A	Monitorimi i rregullt i zbatimit të objektivave të SNK-së
Hapi i veprimit 5: Futja dhe monitorimi i zbatimit të objektivave të SNK-së në Politikën për Mbrojtje të Shëndetit				
Institucioni përgjegjës	Afati kohor	Resurset nevojshme	Sfidat mundshme	Rezultati
MMPH/personi apo grupi përgjegjës	2016 - 2024	N/A	N/A	Monitorimi i rregullt i zbatimit të objektivave të SNK-së
Hapi i veprimit 6: Futja dhe monitorimi i zbatimit të objektivave të SNK-së në Politikën për Mbrojtje të Pyjeve				
Institucioni përgjegjës	Afati kohor	Resurset nevojshme	Sfidat mundshme	Rezultati
MMPH/personi apo grupi përgjegjës	2016 - 2024	N/A	N/A	Monitorimi i rregullt i zbatimit të objektivave të SNK-së
Hapi i veprimit 7: Monitorimi i objektivave të SNK-së të integruara në Planin Strategjik për Menaxhimin e Mbeturinave (PSMM) dhe planet komunale për menaxhimin e mbeturinave				
Institucioni përgjegjës	Afati kohor	Resurset nevojshme	Sfidat mundshme	Rezultati
MMPH/personi apo grupi përgjegjës	2016 - 2024	N/A	N/A	Monitorimi i rregullt i zbatimit të objektivave të SNK-së
Hapi i veprimit 8: Monitorimi i objektivave të SNK-së të integruara në planet e menaxhimit të ujërave tokësore (apo objektivat për menaxhimin e ujërave tokësore në dokumentet tjera sektoriale strategjike)				

Institucioni përgjegjës	Afati kohor	Resurset nevojshme	Sfidat mundshme	Rezultati
MMPH/personi apo grupi përgjegjës	2016 - 2024	N/A	N/A	Monitorimi i rregullt i zbatimit të objektivave të SNK-së

3. Përmirësimi i krijimit të informatave, shfrytëzimit të informatave dhe komunikimit

Lloji i masës: Administrative/Institucionale		Sektori: të gjitha		
Objekti: Përmirësimi i gjenerimit të informatave, shfrytëzimit të informatave dhe komunikimit				
Hapi i veprimit 1: Zhvillimi i veglave të TI-së dhe procedurave administrative për mbledhje dhe shkëmbim të dhënash				
Institucioni përgjegjës	Afati kohor	Resurset nevojshme	Sfidat mundshme	Rezultati
Qeveria	2016 - 2024	N/A	N/A	Mbledhja dhe shkëmbimi i të dhënave i përmirësuar
Hapi i veprimit 2: Fuqizimi i pjesëmarrjes së palëve të interesit në vendim-marrje lidhur me ndryshimet klimatike				
Qeveria	2016 - 2024	N/A	N/A	Pjesëmarrja e palëve të interesit e përmirësuar
Hapi i veprimit 3: Përmirësimi i bashkëpunimit ndër-sektorial				
Institucioni përgjegjës	Afati kohor	Resurset nevojshme	Sfidat mundshme	Rezultati
Qeveria	2016 - 2024	N/A	N/A	Bashkëpunimi i përmirësuar
Hapi i veprimit 4: Përmirësimi i bashkëpunimit ndërmjet niveleve administrative				
Institucioni përgjegjës	Afati kohor	Resurset nevojshme	Sfidat mundshme	Rezultati
Qeveria	2016 - 2024	N/A	N/A	Bashkëpunimi i përmirësuar
Hapi i veprimit 5: Përmirësimi i bashkëpunimit përtej kufijve administrativ				
Institucioni përgjegjës	Afati kohor	Resurset nevojshme	Sfidat mundshme	Rezultati
Qeveria	2016 - 2024	N/A	N/A	Bashkëpunimi i përmirësuar

4. Trajnimi i profesionistëve

Lloji i masës: Administrative/trajnim		Sektori: të gjitha		
Objekti: Përmirësimi i gjenerimit të informatave, shfrytëzimit të informatave dhe komunikimit				
Hapi i veprimit 1: Trajnimi për ndryshime klimatike për profesionistët e avancuar për ujëra, bujqësi, pylltari, planifikim të shfrytëzimit të tokave, shëndet publik, etj.				
Institucioni përgjegjës	Afati kohor ⁷ (TBC)	Resurset nevojshme	Sfidat mundshme	Rezultati
Qeveria/Organet e administratës publike	(2016 – 2024)	N/A	N/A	Njohuritë dhe aftësitë e personelit të përmirësuara
Hapi i veprimit 2: Trajnimi i personelit të Institutit Hidrometeorologjik/stacioneve lokale meteorologjike				
Institucioni përgjegjës	Afati kohor	Resurset nevojshme	Sfidat mundshme	Rezultati
Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës /	2018 (Tremujori i IV-të)	Nuk janë vlerësuar	Disponueshmëria e fondeve	Kapacitetet e fuqizuara të zyrtarëve të institucioneve lokale për të marrë në mënyrë të vazhdueshme të dhënat e

⁷ Të konfirmohet në dokument planifikues ndaras

Stacionet lokale meteorologjike				regjistruara, për t'i analizuar të dhënat, për të përdorur modelet numerike dhe softuerët për simulim dhe parashikim të ndikimit të ndryshimeve klimatike në resurset ujore dhe shërbimet e eko-sistemit
Hapi i veprimit 3: Trajnimi për përdorimin e mirëfilltë të objekteve dhe pajisjeve të ndërlidhura për trajtimin e plehut organik				
MBPZHR	2016 - 2024	N/A	N/A	Njohuritë dhe aftësitë e fermerëve apo personelit të punësuar në ferma të përmirësuara
Hapi i veprimit 4: Trajnimi për GIS për hartëzimin e zonave të prirura për rrezik				
Institucioni përgjegjës	Afati kohor	Resurset nevojshme	Sfidat mundshme	Rezultati
MMPH/MBPZHR	2016 - 2024	N/A	N/A	Njohuritë dhe aftësitë e personelit të përmirësuara
Hapi i veprimit 5 Trajnimi për praktikatat efiçente të menaxhimit të ujitjes për fermerë				
Institucioni përgjegjës	Afati kohor	Resurset nevojshme	Sfidat mundshme	Rezultati
MMPH/MBPZHR	2016 - 2024	N/A	N/A	Njohuritë dhe aftësitë e fermerëve të përmirësuara
Hapi i veprimit 6: Trajnimi për negociatat për klimën sipas UNFCCC-së dhe BE-së				
Institucioni përgjegjës	Afati kohor	Resurset nevojshme	Sfidat mundshme	Rezultati
MMPH	2016 - 2024	N/A	N/A	Njohuritë dhe aftësitë e personelit të përmirësuara
Hapi i veprimit 7: Trajnimi për inventarizimin e GS-ve dhe parashikimet për emetime				
Institucioni përgjegjës	Afati kohor	Resurset nevojshme	Sfidat mundshme	Rezultati
AMMK/MMPH	2016 - 2024	N/A	N/A	Njohuritë dhe aftësitë e personelit të përmirësuara

5. Intervencimet për ndërgjegjësim publik

Lloji i masës: Ndërgjegjësimi publik		Sektori: të gjitha		
Objekti: Ndërgjegjësimi publik për ndryshimet klimatike të përmirësuara				
Hapi i veprimit 1: Fushatë ndërgjegjësimi publik për ruajtjen e ujit dhe grumbullimin e ujit nga reshjet				
Institucioni përgjegjës	Afati kohor	Resurset nevojshme	Sfidat mundshme	Rezultati
MMPH/MBPZHR	2016 - 2024	N/A	N/A	Ruajtja e ujit
Hapi i veprimit 2: Programe për ngritje të vetëdijes për praktikuesit mjekësor për ndikimet negative të ndryshimeve klimatike				
Ministria e Shëndetësisë	2016 - 2024	N/A	N/A	Ndërgjegjësimi i përmirësuar i personelit mjekësor lidhur me ndryshimet klimatike
Hapi i veprimit 3: Promovimi i praktikave efiçente për shfrytëzimin e transportit publik rrugor dhe hekurudhor në vend të automjeteve individuale, promovimi i ecjes dhe çiklizmit				
Institucioni përgjegjës	Afati kohor	Resurset nevojshme	Sfidat mundshme	Rezultati
Ministria e Transportit dhe Postë Telekomunikacionit	2016 - 2024	N/A	N/A	Ndërgjegjësimi publik i përmirësuar lidhur me transportin alternativ

Hapi i veprimit 4: : Promovimi i praktikave të mira bujqësore (ruajtja e plehut organik, metodat e përgatitjes dhe aplikimit, aplikimi i mirëfilltë i plehrave minerale dhe atyre organike, kompostimi shtëpiak)				
Institucioni përgjegjës	Afati kohor	Resurset nevojshme	Sfidat mundshme	Rezultati
MBPZHR	2016 - 2024	N/A	N/A	Ndërgjegjësimi publik i përmirësuar lidhur me praktikatat e mira bujqësore
Hapi i veprimit 5: Planifikimi i veprimeve tjera për ndërgjegjësim publik, duke përdorur ngjarje dhe raste të veçanta për aktivitete të PV-së				
Institucioni përgjegjës	Afati kohor	Resurset nevojshme	Sfidat mundshme	Rezultati
MMPH/GPNM/personi apo grupi përgjegjës	2016 - 2024	N/A	N/A	Planifikimi strategjik i aktiviteteve për ndërgjegjësim publik

6. Zhvillimi i pakos së taksës klimatike

Lloji i masës: Financiare		Sektori: Horizontal		
Objektivi: Zhvillimi i pakos së taksës klimatike				
Hapi i veprimit 1: Realizimi i studimit të fizibilitetit për mundësit e stimulimeve përmes taksave dhe tarifave të cilat janë në të mirë të klimës duke marrë në konsideratë praktikatat ndërkombëtare dhe rrethanat ekonomike vendore				
Institucioni përgjegjës	Afati kohor	Resurset nevojshme	Sfidat mundshme	Rezultati
MZHE/MeF	2019 (Tremujori i II-të)	Nuk janë vlerësuar	Disponueshmëria e ekspertizës	Vizion i qartë për politikën fiskale që ka të bëjë me SNK-në
Hapi i veprimit 2: Ndryshimi i kornizës ligjore				
Institucioni përgjegjës	Afati kohor	Resurset nevojshme	Sfidat mundshme	Rezultati
Qeveria/Ministritë kompetente	2021 (Tremujori i IV-të)	N/A	Kohëzgjatja e procedurave administrative, vullneti politik	Masat financiare dhe ekonomike për të luftuar ndryshimet klimatike janë ligjërish të detyrueshme
Hapi i veprimit 3: Monitorimi dhe vlerësimi i efekteve të intervenimeve financiare dhe ekonomike				
Institucioni përgjegjës	Afati kohor	Resurset nevojshme	Sfidat mundshme	Rezultati
MZHE/MeF	2024 (Tremujori i IV-të)	12-15 mill (€) (Vlerësimi total për këtë objektivi)	N/A	Të dhënat për efektet e masave fiskale/financiare të implementuara

7. Krijimi i Sistemit Kombëtar të Inventarizimit

Lloji i intervenimit: Administrative		Sektori: Ngritja e kapaciteteve		
Objektivi: Sistemi Kombëtar i Inventarizimit të GS-ve i krijuar dhe funksional				
Hapi i veprimit 1: Futja e kërkesave kryesore të Rregullores 525/2013 EU në kornizën ligjore kombëtare				
Institucioni përgjegjës	Afati kohor	Resurset nevojshme	Sfidat mundshme	Rezultati
AMMK/MMPH	2017 (Tremujori i III-të)	N/A	Disponueshmëria e ekspertizës	Obligimi për ofrim të të dhënave i rregulluar për të gjithë bartësit e të dhënave, duke përfshirë formatin dhe shpeshësinë e raportimit
